



Sh.A.F.P Sigal Life UNIQA Group Austria sha

RAPORTI VJETOR 2020

Fondi I Pensionit Vullnetar SIGAL

Raporti vjetor nuk është një ofertë ose reklamë për fondet e Pensionit apo Fondin e Investimit SIGAL Uniqa Invest sha.

Ky raport përmban pasqyrat financiare të shoqërisë administruese dhe secilit prej fondeve që ajo administron për vitin 2020, të audituara nga shoqëria GRANT THORTON sh.p.k.



PËRMBAJTJA

Sh.A.F.P Sigal Life UNIQA Group Austria sha

Rreth nesh

Misioni

Vizioni

Vlerat dhe premtimi ynë

Organet drejtuese

Transparenca

Investimet

Performanca e Fondeve deri më 31.12.2020

Historiku Tarifës Administrative

Fondi i Pensionit VULLNETAR SIGAL

Performanca e Fondit

Strategjia e Investimit



SH.A.F.P SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SHA– Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. është person juridik i themeluar më 21.01.2006 dhe i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më datë 31.01.2006 me NUIS – K61423001P, me seli në Rr. “Ukraina e Lirë”, pas Kullave Binjake, midis Ambasadës së Kosovës dhe asaj Zvicerane (Pallati i Ri Teknoprojekt), Tiranë, me licencë nr. 2, datë 28.04.2020 lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, përfaqësuar nga Z. ELVIS PONARI, Administrator.

Shoqëria Administruese ka si objekt të aktivitetit të saj veprimtarinë e administrimit të fondeve të pensionit privat dhe të aktiveve të sipërmarrjes së investimeve kolektive, mbështetur në licencën nr. 2, datë 28.04.2020, lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Shoqëria administruese ka nën administrim:

- Fondi i Pensionit VULLNETAR SIGAL – Fond Pensioni Privat me Pjesëmarrje të Hapur, licencuar me vendim nr. 51 datë 30.03.2011 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Misioni ynë është të ndihmojmë njerëzit që investimet e përditshme, sado të vogla, t’i kthejnë në ëndrrat e tyre, sado të mëdha. Ne punojmë me përgjegjësi sociale për një biznes që të rritet vazhdimisht dhe që kontribuon për një jetë cilësore për punonjësit tanë, partnerët dhe komunitetin tone. Qëllimi ynë është që ti sigurojmë të gjithë anëtarëve të fondeve SIGAL, mundësinë e një pensioni të përshtatshëm për të ruajtur standartin e jetesës sipas kërkesave, nevojave dhe pritshmërove të tyre, duke maximizuar përfitimet nëpërmjet administrimit të kujdesshëm të aseteve.

Vizioni ynë është të punojmë për suksesin dhe fuqizimin e pozitave tona financiare rajonale, duke u fokusuar në ruajtjen dhe forcimin e mëtejshëm të pozicionit tone në treg përmes qëndrueshmërisë financiare, produkteve dhe shërbimeve cilësore, profesionalizmit dhe transparencës përtë gjithë anëtarët tanë.

Vlerat tona

- ✓ Klienti është në qendër të vëmëndjes
- ✓ Respekt, përkujdesje, mirënjohje, tolerance dhe dëgjim aktiv
- ✓ Disiplinë, vetkontroll, sjellje model
- ✓ Entuziazëm, gadishmëri dhe punë me pasion dhe dashuri
- ✓ Kreativitet
- ✓ Integritet, përgjegjshmëri, sinqeritet dhe mbajtje e fjalës së dhënë
- ✓ Ambicie për progress, këmbëngulje, otimizëm dhe Qëndrim pozitiv
- ✓ Angazhim për exelencë dhe përmirësim I vazhdueshëm në çdo gjë që bëjmë.



Premtimi ynë është të punojmë sëbashku duke u bazuar në misionin dhe vlerat tona për të krijuar Deklaratën e premtimit e cila shpreh atë çfarë anëtarët presin prej nesh:

Ne do të:

- ✓ Jemi pranë jush për tju siguruar nivelin më të lartë të shërbimit.
- ✓ Veprojmë në interesin tuaj më të mirë dhe administrojmë investimet dhe pagesat e pensionit me profesionalizëm.
- ✓ Sigurojmë informacion të saktë në kohën e duhur dhe në menyrë konfidenciale.
- ✓ Kemi stafin dhe strategjinë e duhur për të administruar më mirë pensionin tuaj .
- ✓ Përfaqësojmë dhe mbrojmë interesat tuaja duke u siguruar që zëri juaj të dëgjohet.

Organet Drejtuese të Shoqërisë Administruese janë:

I. Asambleja e Aksionarëve

Asambleja e Aksionarëve përbëhet nga këta përfaqësues ligjorë të shoqërisë:

- 1. Edvin Hoxhaj**, Shoqëria "SIGAL LIFE UNIQA Group sh.a.
- 2. Avni Ponari**, CEO SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a.

II. Këshilli i Administrimit

Këshilli i Administrimit përbëhet nga 5 anëtarë:

- | | |
|---------------------------|---------|
| 1. Adrian Totokoçi | Kryetar |
| 2. Abdyl Sarja | Anëtar |
| 3. Edvin Hoxhaj | Anëtar |
| 4. Klement Mersini | Anëtar |
| 5. Elvis Ponari | Anëtar |



Këshilli i Administrimit ka kompetencë kontrollin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare, zhvillimin e biznesit të shoqërisë administruese, miraton politikat financiare dhe politikat e investimit, emëron dhe shkarkon administratorët ose anëtarët e komitetit të investimit. Këshilli i Administrimit angazhohet që shoqëria administruese të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit.

Z. Adrian Totokoci, vjen nga një eksperiencë e gjatë në fushën e menaxhimit dhe ekonomisë, me përvojë në pozicione drejtuese në institucione shtetërore të tregtisë së jashtme.

Z. Totokoçi është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik (1980-1985). Z. Totokoçi ka kryer studime pasuniversitare në Universitetin e Manhattan-it (1992-1993) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Aktualisht ai është:

- Administrator i Përgjithshëm, Kompania ALTO Sh.p.k, Përfaqësuese Zyrtare e Markës Toyota në Shqipëri.
- Administrator i Përgjithshëm, Kompania AVEL Sh.p.k, Përfaqësuese Zyrtare e Markës Peugeot në Shqipëri,
- Anëtar Bordi i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri-Japoni.

Z. Abdyl Sarja, në cilësinë e Drejtorit të Departamentit Juridik të shoqërisë më të madhe të Sigurimeve në Shqipëri “SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a.” sh.a. ka një përvojë të mirë të vendosjes së standardeve organizative e ligjore të shoqërisë.

Z. Sarja prej vitit 2013 është Sekretar i Përgjithshëm i “SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a.” sh.a.

Ai është diplomuar si Jurist në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (1996-2000). Z. Sarja ka titullin master në Të Drejtat Evropiane dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare në Francë (2003-2004) dhe Titulli i Avokatit (që nga viti 2005). Gjithashtu ka marrë disa kualifikime dhe trajnime në Shqipëri dhe jashtë saj.

Pas diplomimit, Z. Sarja ka punuar si Avokat Specialist pranë Këshillit të Qarkut, Tiranë (2000-2002); si Specialist në Sektorin Juridik në Departamentin e Mbështetjes Profesionale; (2002-2004), si Përgjegjës i Sektorit Juridik (2004-2005) dhe në fund si Drejtor i Drejtorisë Ligjore dhe Licencimit të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve (sot Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare) (2005-2006).



Z. Sarja është anëtar bordi i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a.Kosovë (që nga viti 2008) dhe Kryetar i Komitetit Ligjor të Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë. Ai ka shërbyer edhe për dy mandate si Anëtar i Këshillit Bashkiak të Tiranës.

Z. Abdyl Sarja nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

Z.Edvin Hoxhaj, Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë “SIGAL LIFE UNIQA GROUP sh.a. me një eksperiencë të pasur në fushën e sigurimeve në përgjithësi dhe atë të jetës e risigurimeve në veçanti.

Z. Edvin Hoxhaj është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik (1984-1988). Ai ka ndjekur Studime Postuniversitare për Vlerësimet e Pasurive të Paluajtshme në Universitetin Politeknik, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, në vitet 1993-1994.

Ai gjithashtu ka marrë disa kualifikime dhe trajnime në Shqipëri dhe jashtë vendit, kryesisht mbi Sigurimet (Jo Jetë dhe Jetë) dhe Risigurime si dhe për Menaxhim Biznesi.

Z. Hoxhaj e filloi karrierën e tij në industrinë e sigurimeve duke punuar në Institutin e Sigurimeve të Shqipërisë në Korrik 1992, ku ka mbajtur disa pozicione: Menaxheri i Zyrës së Sigurimit të Pronës (1992-1996); Drejtor i Departamentit Motorik (1996-1998) dhe Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm dhe Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës (1997-1999). Nisur nga përgatitja e plotë dhe përvoja e tij e gjatë, Z. Hoxhaj është kontribues në disa subjekte në tregun e sigurimeve në vend dhe në Ballkan.

Aktualisht është anëtar bordi i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a., Kosovë (që nga viti 2012)

Z. Edvin Hoxhaj nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

Z.Klement Mersini ka një formim e eksperiencë të pasur në fushën financiare.

Aktualisht, Z.Mersini mban postin e Drejtorit të Departamentit Financiar në kompaninë më të madhe të Sigurimeve në Shqipëri SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a.

Z. Mersini është diplomuar pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës në degën Financë – Kontabilitet (1994-1998), ndërsa ka vijuar studimet pasuniversitare dhe aktualisht është kandidat për PhD. Z. Mersini është Kontabël i Miratuar (që nga viti 2002) dhe Ekspert Kontabël i Autorizuar (që nga viti 2010). Ai gjithashtu ka marrë disa kualifikime dhe trajnime



në Shqipëri dhe jashtë vendit, kryesisht për mbikëqyrjen dhe raportimet në shoqëritë e sigurimit, menaxhimin e rrezikut, menaxhimin e aktiveve, Solvency 2, IFRS 4, IFRS 17, etj.

Z. Klement Mersini nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

Z. Elvis Ponari është Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë Administruese të Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive “Sh.A.F.P dhe S.I.K Sigal Life UNIQA Group Austria sha” sh.a.. Z. Ponari është inxhinier financiar me arsim pasuniversitar, zotëron master në Administrim Biznesi (MBA) në banka dhe sigurime dhe master shkencor (MSc) në Financë. Me një eksperiencë 10 vjeçare në sigurime në Vjenë, Austri, ku ka mbajtur pozicionin si Drejtor Rajonal në UNIQA Group Austria. Gjithashtu, Z. Elvis Ponari ka dhe një eksperiencë 3 vjeçare si drejtues në Bankën e Shqipërisë dhe më pas në rolin Drejtues Ligjor i kompanisë vendase ALBGAZ. Aktualisht, është dhe anëtar bordi tek SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a. në Kosovë.

Përpos ekspertizës, Z. Elvis Ponari ka qenë lektor në trajnime të shumta në fushën e auditimit, mbikëqyrjes, menaxhimit të rrezikut, menaxhimit financiar dhe buxhetimit në universitete dhe në institucione financiare vendase dhe të huaja.

Z. Elvis Ponari, nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

Transparenca

Shoqëria Administruese siguron një transparencë të vazhdueshme për anëtarët e fondit duke i informuar për situatën e aktiveve të tyre nëpërmjet:

- a) Sistemit duke mundësuar kontroll 24 orë në llogaritë individuale të anëtarëve në faqen e internetit www.fondisigal.com.al, ku anëtarët me mjete elektronike të informohen në çdo kohë duke aksesuar llogarinë individuale për aktivet përfshirë vlerësimin e vlerës neto të aktiveve, totalin e ndryshimit të aktiveve për periudhën 12 -muajore, normën e kthimit nga investimi për fondin për periudhën 12-mujore, kthimin



nga investimi, që nga fillimi i pjesëmarrjes në fond, datat e kontributeve dhe transferimet e aktiveve të bëra nga ose në emër të anëtarit gjatë periudhës përkatëse.

b) Shoqëria administruese harton një dokumentin “Vërtetim për gjendjen e llogarisë së pensionit të anëtarit të fondit.”. për gjendjen e llogarisë së pensionit për çdo anëtar të Fondit të Pensionit Vullnetar SIGAL dhe SIGAL PRO. Vërtetimi i vihet në dispozicion çdo anëtar, pa pagesë, në formë elektronike, të paktën 1 (një) herë në vit. Krahas çdo informacioni në formë elektronike, anëtarëve u jepet edhe një kopje fizike me kërkesë të tyre.

Shoqëria administruese publikon vlerën neto të aktiveve dhe vlerën neto të kuotës së fondit në ditën e vlerësimit. Prospektin, raportet financiare të ndërmjetme (çdo 3-muaj), raportin vjetor të audituar (1herë/vit) ose botime të tjera të publikuara nga shoqëria administruese. Ky informacion publikohet në faqen zyrtare të shoqërisë administruese. Krahas çdo informacioni në formë elektronike, anëtarëve u jepet edhe një kopje fizike me kërkesë të tyre.

Shoqëria Administruese është gjithashtu në komunikim të vazhdueshëm me anëtarët si nëpërmjet e-mail apo telefonatave duke i sqaruar çdo pyetje apo kërkesë që lidhet me investimin e tyre.

Investimet

Objekti i investimit të fondeve që Shoqëria Administruese Administron është:

- Investimi në tituj të Qeverisë shqiptare me afat të gjatë gjë e cila maksimizon kthimin afatgjatë të investimit.
- Investimi në tituj të Qeverisë Shqiptare e cila siguron normë më të lartë kthimi dhe maksimizim të fitimit të Fondit të Pensionit.
- Administrim i kujdesshëm dhe konservator i rrezikut të investimit. Për këtë arsye objektivi i investimit është investimi në instrumente financiare me rrezik sa më të ulët.
- Portofoli i investimeve do të ndërtohet nga obligacione afatgjatë të emetuara dhe garantuara nga Republika e Shqipërisë me synimin e maksimizimit të fitimit të kushtëzuar nga kufijtë e rrezikut dhe likuiditetit.

Performanca e Fondeve më 31.12.2020

Kthimi neto nga Investimi	Fondi SIGAL
31.12.2019 - 31.12.2020	3.26%

Kthimi nga investimi i fondeve që shoqëria Administruese ka nën administrim të saj kanë një rritje të kthimit nga investimi me ritme të kënaqshme dhe kjo falë një strategjie të menaxhimit efikas bazuar në analiza dhe vendimarrje të orientuar drejt performancës afatgjatë.

Historiku Tarifës Administrative

VITI	2011 - 2019	2020
Tarifa Administrimit	3%	2.50%

Shoqëria administruese për t'ju përmbajtur sa më mirë misionit, vizionit dhe vlerave të saj ka rishikuar në vazhdimësi tarifën e administrimit duke e ulur atë në mënyrë të ndjeshme.

Tarifa më 31.12.2020 ka qënë 2.50% nga 3.00% që ishte në vitin 2019. Ky veprim është bërë që shoqëria ti përmbahet premtimit të saj për të qënë sa më pranë investitorëve për ti siguruar atyre një kthim më të lartë.

Fondi i Pensionit Vullnetar SIGAL

Fondi i Pensionit Vullnetar SIGAL - është aktualisht fondi më i madh në tregun e Pensioneve private në Shqipëri me një vlerë asetesh 1,592,262,936 lekë. Aktivet e Fondit janë tërësisht të ndara prej aktiveve të tjera të administruara nga Shoqëria Administruese dhe nuk mund të jenë objekt i pretendimeve ose ekzekutimeve, të kryera në emër dhe për llogari të kreditorëve të Shoqërisë Administruese.

Të dhënat kryesore për Fondin në 31 Dhjetor 2020

Vlera Neto e Aseteve	1,592,262,936 Lekë
Numri i anëtarëve	8,431
Çmimi i Kuotës	1,496.0991Lekë
*Fitimi vjetor (31/12/19-31/12/20)	3.26 %

Fondi i Pensionit Vullnetar SIGAL ka për qëllim të maksimizojë kthimin afatgjatë të investimit nëpërmjet administrimit të kujdesshëm dhe konservator të rrezikut të investimit. Asetet e Fondit do të investohen me synim për të rritur kthimin nga investimi për anëtarët e tij dhe për t'ju siguruar atyre një të ardhme të sigurt.

Strategjia e investimit

Të gjitha investimet kryhen në mënyrë të matur dhe të përgjegjshme duke mbajtur parasysh ruajtjen e vlerës së kapitalit dhe të një niveli të mjaftueshëm likuiditeti, për të përmbushur të gjitha detyrimet e tashme dhe të ardhshme në momentin që këto të fundit bëhen të pagueshme.

Fondi investoi gjatë vitit 2020 kryesisht në obligacione afatgjatë të shtetit shqiptar me afate 10 vjeçare për shkak të kohës së largët të daljes në pension si dhe për shkak të maksimizimit të fitimit për anëtarët e fondit.

Në 31 dhjetor 2020 struktura e portofolit të investimeve të Fondit të Pensionit Vullnetar SIGAL PENSION paraqitet si më poshtë:

Tituj Të Qeverisë Shqiptare (Obligacione)	1,550,227,893	97.07%
Mjete monetare (Llogari rrjedhese)	46,758,150	2.93%

Performanca

Aktiviteti neto të Fondit të pensionit Vullnetar SIGAL më 31.12.2020 arritën vlerën 1,592,262,936 lekë me një rritje prej 19.45% krahasuar me vitin 2019.

Numri i anëtarëve të fondit është rritur me 7.69% krahasuar me vitin paraardhës, gjë që tregon rritje të interesit dhe të besimit të individëve ndaj Fondit të Pensionit Vullnetar SIGAL.

Kthimi nga Investimi për vitin e fundit 31.12.2021-31.12.2020 ka qënë 3.26% ndërkohë kthimi që prej fillimit aktivitetit është 4.21%

Tregues të Riskut në 31 Dhjetor 2020

FONDI	Kohëzgjatja	Devijimi standart	Treguesi sistetik i rrezikut	Kthimi Mesatar Vjetor	Kthimi që prej fillimit
Fondi Pensionit Vullnetar SIGAL	4.25	0.0107%	1	3.26%	4.21%

Treguesi i riskut sintetik në tabelë jep informacion mbi nivelin e rrezikut të fondit (nga niveli 1, rrezik shumë I ulët deri në nivelin 7, rrezik shumë I lartë). Fondet e Pensionit Privat kanë një nivel rreziku 1, që do të thonë rrezik I ulët, profil shumë konservator dhe të qëndrueshëm. Fondi I Investimit Sigal Invest ka një nivel rreziku 3 që do të thotë rrezik mesatar, më dinamik dhe më I përshtashëm për investitorët që pranojnë më shumë rrezik në këmbim të potencialit më të lartë për kthim.

Administrimi i Riskut kryhet nga një njësi e pavarur e cila mat, monitoron, dhe raporton në Këshillin e Administrimit, Komitetin e Investimit dhe AMF respektimin e limiteve dhe treguesit e ndryshëm të riskut. Ky departament është i ngarkuar me identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve të lidhura me investimet. Kjo përfshin analizën e rreziqeve financiare, operacionale, dhe të tregut, që mund të ndikojnë në kthimin e investimeve.

Për fondin e Pensionit Vullnetar SIGAL treguesit kanë qënë stabël dhe luhatshmëria ka qënë e ulët, të gjitha investimet e fondeve mbahen deri në maturim.

Devijimi Standart mat variacionin e kthimeve pra rrezikun total të Fondit. Fondi I Pensionit Vullnetar SIGAL është një fond I qëndrueshëm dhe thuajse pa luhatje të kthimeve.



Pasqyrat Financiare
Më 31.12.2020

Fondi i Pensionsi Vullnetar SIGAL

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

• Pasqyra e Aktiveve të Fondit 31.12.2020

	Lek	
	Periudha e mëparshme 31.12.2020	Periudha aktuale 31.12.2021
1. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	36,831,170	46,758,150
2. Investime	1,275,446,643	1,520,454,451
3. Të Tjera llogari të Arkëtueshme	24,787,855	29,773,442
TOTALI I AKTIVEVE	1,337,065,668	1,596,986,043
4. Detyrime ndaj shoqërisë administruese	3,350,908	3,345,928
5. Detyrime nga ndryshimi i anëtarësisë	681,826	1,377,179
TOTALI I DETYRIMEVE	4,032,734	4,723,107
AKTIVET NETO TË FONDIT TË PENSIONIT	1,333,032,933	1,592,262,936
NUMRI I KUOTAVE TE FONDIT TE PENSIONIT	920,026	1,064,276
AKTIVET NETO PËR KUOTË TË FONDIT TË PENSIONIT	1,448.9078	1,496.0991

• Pasqyra e Veprimtarisë 31.12.2020

	Lek	
	Periudha mëparshme 31.12.2019	Periudha Aktuale 31.12.2020
Të ardhura nga interesat e letrave me vlerë Obligacione	76,007,489	86,435,398
Të ardhura nga interesa depozita bankare	130,284	204,443
TOTALI I TË ARDHURAVE NGA INVESTIMET	76,137,772	86,639,840
Tarifa për shoqërinë administruese	35,896,110	39,575,435
Shpenzime të tjera/provigjone	(5,217,500)	-
Totali Shpenzimeve	30,678,610	39,575,435
TOTALI I FITIMEVE (HUMBJEVE)	45,459,162	47,064,406

• Pasqyra e ndryshimeve te aktiveve neto 31.12.2020

	Periudha e meparshme 31.12.2019	Periudha aktuale 31.12.2020
RRITJA (ZVOGËLIMI) I AKTIVEVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT	45,459,162	47,064,406
Kontribute nga anëtarët e fondit	261,326,363	291,675,255
Tërheqje e aktiveve	(59,398,315)	(79,509,657.46)
Rritja në Aktivet e Fondit	247,387,210	259,230,003
Kuota të pensionit të emetuara mbi bazën e kontributeve	183,104	198,046.1579
Tërheqje të kuotave	(41,777)	(53,795.86)
NUMRI I KUOTAVE TË PENSIONIT	141,327	144,250

Bazuar në informacionet e mësipërme, Viti 2020 ishte një vit me performancë të qëndrueshme të fondeve të pensionit si dhe Fondit të Investimit. Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal vazhdoi të ofrojë kthime të qëndrueshme me rrezik shumë të ulët, duke përmbushur objektivin e tij primar, ruajtjen dhe rritjen graduale të kursimeve të anëtarëve për një pension të sigurt dhe të qëndrueshëm.

Të gjithë treguesit e rrezikut, kthimit dhe kohëzgjatjes janë monitoruar rregullisht dhe janë menaxhuar në përputhje me strategjinë e investimit dhe objektivave staturore të fondeve. Përgjatë vitit 2020, menaxhimi profesional, transparencja dhe përkushtimi ndaj sigurisë së investimeve kanë mbetur në qendër të veprimtarisë tonë.

Duke parë përpara, synojmë të vijojmë me të njëjtin standart profesional, të zgjerojmë bazën e anëtarëve dhe të ofrojmë zgjidhje të përshtatura me nevojat në ndryshim të investitorëve tanë.